L I G J
Nr.8556, datë 22.12.1999

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KONVENTËN E KOMBEVE TË BASHKUARA "PËR TË LUFTUAR SHKRETËTIRËZIMIN NË ATO VENDE QË KANË KALUAR THATËSIRË SERIOZE DHE/OSE SHKRETËTIRËZIM, VEÇANËRISHT NË AFRIKË"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës dhe të nenit 17 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në Konventën e Kombeve të Bashkuara "Për të luftuar shkretëtirëzimin në ato vende që kanë kaluar thatësirë serioze dhe/ose shkretëtirëzim, veçanërisht në Afrikë."

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2508, datë 30.12.1999 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

KONVENTA
E KOMBEVE TË BASHKUARA PËR TË LUFTUAR SHKRETËTIRËZIMIN NË ATO VENDE QË KANË KALUAR THATËSIRË SERIOZE DHE/OSE SHKRETËTIRËZIM, VEÇANËRISHT NË AFRIKË

Palët për këtë Konventë:

Duke afirmuar që njerëzit në zonat e prekura ose të kërcënuara janë në qendër të preokupimit për luftimin e shkretëtirëzimit dhe zbutjen e efekteve të thatësirës,

Duke reflektuar preokupimin urgjent të komunitetit ndërkombëar, përfshirë shtetet dhe organizatat ndërkombëtare, për ndikimet e kundërta të shkretëtirëzimit dhe thatësirës,

Të vetëdijshëm që zonat e thata, gjysmë të thata - në të lagëta konsiderohen së bashku si një raport i rëndësishëm i zonës së sipërfaqes së Tokës dhe janë habitat dhe burim i jetesës për një segmet të gjerë të popullsisë së vet,

Duke pranuar që shkretëtirëzimi dhe thatësira janë probleme të dimensionit global në atë që ato prekin të gjithë rajonet e botës dhe se nevojitet aksion i përbashkët i komunitetit ndërkombëtar për të luftuar shkretërirëzimin dhe/ose për të zbutur efektin e thatësirës,

Duke vërejtur përqendrimin e lartë të vendeve në zhvillim, veçanërisht të vendeve më të vogla të zhvilluara, ndër ato që kalojnë thatësirë serioze dhe/ose shkretëtirëzim, dhe veçanërisht pasojat tragjike të këtyre fenomeneve në Afrikë,

Duke vërejtur gjithashtu që shkretëtirëzimi shkaktohet nga ndërveprimet komplekse të faktorëve fizikë, biologjikë, politikë, socialë, kulturorë dhe ekonomikë,

Duke konsideruar impaktin e tregtisë dhe aspekteve përkatëse të marrëdhënieve ekonomike ndërkombëtare në aftësinë e vendeve të prekura për të luftuar shkretëtirëzimin si duhet,

Të ndërgjegjshëm, që rritja ekonomike e qëndrueshme, zhvillimi social dhe zhdukja e

varfërisë, janë prioritetet e vendeve të prekura në zhvillim, veçanërisht në Afrikë, dhe janë thelbësore për të plotësuar objektivat e qëndrueshmërisë,

Të kujdesshëm që shkretëtirëzimi dhe thatësira prekin zhvillimin e qëndrueshëm të ndërmarrëdhënieve të tyre me problemet e rëndësishme sociale si varfëria, shëndeti i dobët dhe të ushqyerit keq, mungesa e sigurisë së ushqimit, dhe problemeve që dalin nga emigrimi, zhvendosja e personave dhe dinamika demografike,

Duke vlerësuar rëndësinë e përpjekjeve të kaluara dhe eksperiencën e shteteve dhe organizmave ndërkombëtare në luftën kundër shkretëtirëzimit dhe në zbutjen e efekteve të thatësirës, veçanërisht në zbatimin e Planit të Aksionit për të Luftuar Shkretëtirëzimin, i cili u miratua nga Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Shkretëtirëzimin në vitin 1977,

Duke kuptuar që pavarësisht nga përpjekjet në të kaluarën zhvillimi i luftës kundër shkretëtirëzimit dhe i zbutjes së efektit të thatësirës nuk ka përmbushur parashikimet tona dhe se nevojitet një vizion i ri dhe më efikas në të gjitha nivelet brenda kuadrit të zhvillimit të qëndrueshëm,

Duke njohur vlefshmërinë dhe përkatësinë e vendimeve të miratuara nga Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Mjedisin dhe Zhvillimin vaçanërisht të Axhendës 21 dhe të kapitullit 12 të saj, të cilat japin bazën për luftën kundër shkretëtirëzimit,

Duke riafirmuar në këtë dritë angazhimet e vendeve të zhvilluara siç përmbahet në paragrafin 13 të kapitullit 33 të Axhendës 21,

Duke kujtuar rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme 47/188, veçanërisht prioritetin e paracaktuar për Afrikën, dhe të gjitha rezolutat, vendimet dhe programet e tjera përkatëse të Kombeve të Bashkuara për shkretëtirëzimin dhe thatësirën, si dhe deklaratat përkatëse të bëra nga vendet afrikane dhe atyre nga rajonet e tjera,

Duke riafirmuar Deklaratën e Rios, mbi Mjedisin dhe Zhvillimin, e cila citon në Parimin e saj numër 2, që Shtetet kanë, në përputhje me Kartën e Kombeve të Bashkuara dhe principet e ligjit ndërkombëtar, të drejtën sovrane për të shfrytëzuar burimet e tyre në ndjekje të politikave të veta ambientaliste dhe të zhvillimit, dhe përgjegjësisë për të siguruar që aktivitetet brenda juridiksionit dhe kontrollit të tyre nuk i shkaktojnë dëme mjedisit të shteteve të tjera ose të zonave përtej limiteve të juridiksionit kombëtar,

Duke pranuar që qeveritë nacionale luajnë një rol kritik në luftimin e shkretëtirëzimit dhe zbutjen e efektit të thatësirës dhe ky zhvillim në këtë drejtim varet nga përmbushja e programeve të aksioneve lokale në zonat e prekura,

Duke pranuar gjithashtu rëndësinë dhe nevojën e kooperimit dhe partneritetit internacional në luftimin e shkretëtirëzimit dhe zbutjen e efekteve të thatësirës,

Duke pranuar më tej rëndësinë e sigurimit në zonat e prekura në zhvillim, sidomos në Afrikë, të mjeteve efektive, të burimeve financiare të rëndësishme ndër të tjera, duke përfshirë fondet e reja dhe shtesë, dhe mundësinë e përdorimit të teknologjisë, pa të cilën do të ishte e vështirë për ato të zbatonin plotësisht angazhimet e tyre në këtë Konventë,

Duke shprehur preokupimin për ndikimin e shkretëtirëzimit dhe thatësirës në vendet e prekura të Azisë Qëndrore dhe Transkaukaze,

Duke theksuar rolin e rëndësishëm të luajtur nga gratë në rajonet e prekura nga shkretëtirëzimi dhe/ose thatësira veçanërisht në zonat rurale të vendeve në zhvillim dhe rëndësinë e sigurimit të pjesëmarrjes së plotë të burrave e grave të të gjitha niveleve në programet për të luftuar shkretëtirëzimin dhe zbutur efektin e thatësirës,

Duke theksuar rolin e veçantë të organizatave joqeveritare dhe grupeve të tjera kryesore në programet për të luftuar shkretëtirëzimin dhe zbutur efektin e thatësirës,

Duke pasur parasysh marrëdhëniet ndërmjet shkretëtirëzimit dhe problemeve të tjera të ambientit të dimensionit global që ndeshin komunitetet ndërkombëtare dhe nacionale,

Duke pasur gjithashtu parasysh kontributin që lufta kundër shkretëtirëzimit mund të bëjë në arritjen e objektivave të Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara mbi Ndryshimin e Klimës, Konventës mbi Diversitetin Biologjik dhe konventave të tjera të mjedisit të lidhura me to,

Duke besuar se strategjitë për të luftuar shkretëtirëzimin dhe zbutur efektet e thatësirës do të jenë më efektive në se bazohen mbi një vëzhgim sistematik dhe njohuri shkencore rigoroze dhe në se ato rivlerësohen vazhdimisht,

Duke vënë re nevojën urgjente për të përmirësuar efektivitetin dhe koordinimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në lehtësimin e zbatimit të planeve dhe prioriteteve kombëtare,

Të vendosur për të ndërmarrë aksionet e duhura në luftën kundër shkretëtirëzimit dhe zbutjen e efekteve të thatësirës për të mirën e brezave të tashëm dhe të ardhëm,

Kanë ranë dakord sa më poshtë:

PJESA I
HYRJE

Neni 1
Përdorimi i termave

Për qëllime të kësaj Konvente:

(a) "shkretëtirëzim" do të thotë degradim i tokës në zonat e thata, gjysmë të thata dhe të thata-në të lagta, që vjen nga faktorë të ndryshëm, përfshi këtu ndryshimet klimatike dhe aktivitetet njerëzore;

(b) "lufta kundër shkretëtirëzimit" përfshin aktivitetet, të cilat janë pjesë e zhvillimit të integruar në zonat e thata, gjysmë të thata dhe në të thata-në të lagta, për zhvillimin e qëndrueshëm,të cilat synojnë në:

(i) ndalimin dhe/ose uljen e degradimit të tokës;

(ii) rehabilitimin e tokës së degraduar pjesërisht; dhe

(iii) bonifikimin e tokës së shkretëtirëzuar;

(c) "thatësirë" do të thotë fenomen që ndodh natyrshëm, i cili ekziston kur precipitimi ka qenë nën nivelet normale të regjistruara, duke shkaktuar disbalanca hidrologjike serioze, që ndikojnë keq në sistemet e prodhimit të burimeve të tokës;

(d) "zbutja e efekteve të thatësirës" nënkupton aktivitetet e lidhura me parashikimin e thatësirës dhe që kanë si qëllim të ulin dobësinë e shoqërisë dhe sistemeve natyrore ndaj thatësirës, meqenëse ata lidhen me luftën kundër shkretëtirëzimit;

(e) "tokë" do të thotë sistemi bioproduktiv tokësor që përmban tokën, vegjetacionin, forma të tjera jetësore, dhe proceset ekologjike e hidrologjike që veprojnë brenda sistemit;

(f) "degradim i tokës" do të thotë reduktim ose humbje në zonat e thata, gjysmë të thata dhe të thata-në të lagta të produktivitetit dhe kompleksitetit biologjik apo ekonomik të tokës prodhuese të ushqyer nga shiu, të tokës prodhuese të vaditur, të kullotës, pyllit dhe pyllnajës të cilat krijohen si rezultat i përdorimeve të tokës, apo nga një proces a kombinim procesesh, përfshi proceset që vijnë nga akvititetet njerëzore dhe modelet e vendbanimit, si p.sh:

(i)erozioni i tokës i shkaktuar nga era dhe/ose uji;

(ii)keqësimi i vetive fizike, kimike dhe biologjike apo ekonomike të tokës; dhe

(iii)humbja afatgjatë e vegjetimit natyror;

(g) "zona të thata, gjysmë të thata dhe të thata-në të lagta" do të thotë zona, ndryshe nga rajonet polare dhe nënpolare, në të cilat raporti i precipitimit vjetor ndaj evapotranspirimit potencial bie nga 0,05 në 0,65;

(h) "zona të prekura" do të thotë zonë e thatë, gjysmë e thatë dhe/ose e thatë-në të lagët e prekur ose kërcënuar nga shkretëtirëzimi;

(i) "vende të prekura" do të thotë vende në të cilat tokat përfshijnë tërësisht ose pjesërisht zonat e prekura;

(j) "organizmi i integrimit ekonomik rajonal", do të thotë një organizëm i përbërë nga shtete sovrane të një rajoni të dhënë, i cili ka kompetencë në respektimin e rëndësisë së qeverisjes në bazë të kësaj Konvente dhe ka qenë autorizuar siç duhet, në përputhje me procedurat e veta të brendshme, të firmosë, ratifikojë, pranojë, miratojë ose pajtohet me këtë Konventë;

(k) "Palët e vendeve të zhvilluara" do të thotë palët e vendeve të zhvilluara dhe organizatat e integrimit ekonomik rajonal të përbëra nga vendet e zhvilluara.

Neni 2
Objektivi

1. Objektivi i kësaj Konvente është të luftojë shkretëtirëzimin dhe të zbusë efektet e thatësirës në vendet që kalojnë thatësirë serioze dhe/ose shkretëtirëzim, veçanërisht në Afrikë, nëpërmjet

veprimtarisë efektive në të gjitha nivelet, të përkrahur nga bashkëpunimi dhe partneriteti ndërkombëtar, në kuadrin e drejtimit të integruar, i cili jepet në Axhendën 21, me synimin për të kontribuar në arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm në zonat e prekura.

2. Arritja e këtij objektivi do të inkuadrojë strategjitë afatgjata të integruara që fokusojnë në të njëjtën kohë, në zonat e prekura, produktivitetin e përmirësuar të tokës dhe rehabilitimin, konservimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve të tokës dhe ujore, që çojnë në kushtet e përmirësuara të jetesës veçanërisht në nivel komuniteti.

Neni 3
Parimet

Për të arritur objektivin e kësaj Konvente dhe për të zbatuar dispozitat e saj, Palët do të udhëhiqen, ndërmjet të tjerash, nga sa më poshtë:

(a) Palët duhet të sigurojnë që vendimet mbi hartimin dhe zbatimin e programeve për të luftuar shkretëtirëzimin dhe/ose zbutur efektet e thatësirës merren me pjesëmarrjen e popullatave dhe komuniteteve lokale dhe se krijohet një ambient aftësues në nivelet më të larta për të lehtësuar veprimtainë në nivelin nacional dhe lokal;

(b) Palët duhet, në frymën e solidaritetit ndërkombëtar dhe partneritetit, të përmirësojnë bashkëpunimin dhe koordinimin në nivele nënrajonale, rajonale dhe internacionale dhe, të fokusojnë, burimet financiare, humane, organizative dhe teknike kur janë të nevojshme;

(c) Palët duhet të zhvillojnë, nën frymën e partneritetit, kooperimin ndërmjet të gjithë niveleve të qeverisjes, komuniteteve, organizatave joqeveritare dhe pronarëve të tokës për të vendosur një mirëkuptim më të mirë të natyrës dhe të vlerave të tokës të shpërndarjes së burimeve të ujit në zonat e prekura dhe për të punuar në përdorimin e tyre të mirë; dhe

(d) Palët duhet që të marrin në konsideratë të plotë nevojat speciale dhe rrethanat e vendeve në zhvillim të prekura, veçanërisht ndër ato që janë më pak të zhvilluara.

PJESA II
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 4
Detyrimet e përgjithshme

1. Palët do të zbatojnë detyrimet e tyre nën këtë Konventë, individualisht ose se bashku, ose nëpërmjet organizmave ekzistuese ose perspektive bilaterale e multilaterale ose nëpërmjet një kombinimi, ashtu siç duhet, duke theksuar nevojën për të koordinuar përpjekjet dhe zhvilluar një strategji afatgjatë koherente në të gjitha nivelet.

2. Në ndjekjen e objektivës së kësaj Konvente, Palët:

(a) do të adoptojnë një përqasje të integruar që i drejtohet aspekteve fizike, biologjike dhe social-ekonomike të proceseve të shkretëtirëzimit dhe të thatësirës;

(b) do të japin vëmendje të duhur, brenda organeve përkatëse internacionale dhe rajonale, situatës së palëve të vendeve në zhvillim të prekura, për sa i përket tregtisë ndërkombëtare, përgatitjeve të marketingut dhe borxhit me synimin për të vendosur një ambient ekonomik ndërkombëtar që bën të mundur nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm;

(c) do të integrojnë strategjitë për rrezatimin e varfërisë në përpjekjet për të luftuar shkretëtirëzimin dhe zbutur efektet e thatësirës;

(d) do të nxisin bashkëpunimin ndërmjet palëve të vendeve të prekura në fushat e mbrojtjes së mjedisit dhe të konservimit të tokës dhe burimeve të ujit, meqenëse ato lidhen me shkretëtirëzimin dhe thatësirën;

(e) do të forcojnë bashkëpunimin nënrajonal dhe internacional;

(f) do të bashkëpunojnë brenda organizatave ndërqeveritare përkatëse;

(g) do të përcaktojnë mekanizmat institucionale, në se duhet, duke pasur parasysh nevojën për të shmangur dublikimin; dhe

(h) do të nxisin përdorimin e mekanizmit financiar bilateral dhe multilateral ekzistues dhe, mobilizojnë dhe kanalizojnë burimet financiare të rëndësishme për palët e vendeve në zhvillim që janë

të prekura, në luftën kundër shkretëtirëzimit dhe zbutjen e efekteve të thatësirës.

3. Palët e vendit në zhvillim të prekur janë të zgjedhura për asistencë në zbatimin e Konventës.

Neni 5

Detyrimet e palëve të vendit të prekur

Përveç obligimeve të tyre që vijnë si pasojë e nenit 4, Palët e vendit të prekur ndërmarrin:

(a) të japin prioritetin e duhur në luftën kundër shkretëtirëzimit dhe zbutjen e efekteve të thatësirës dhe për të caktuar resurset adekuate në përputhje me rrethanat dhe mundësitë e tyre;

(b) të vendosin strategjitë dhe prioritet brenda kuadrit të planeve dhe/ose politikave të zhvillimit të qendrueshëm për të luftuar shkretëtirëzimin dhe zbutur efektet e thatësirës;

(c) të adresojnë shkaqet e fshehura të shkretëtirëzimit dhe t'i kushtojnë një vëmendje speciale faktorëve social-ekonomikë që kontribuojnë në proceset e shkretëtirëzimit;

(d) të nxisin njohuritë dhe lehtësojnë pjesëmarrjen e popullatës lokale veçanërisht të grave dhe rinisë në përkrahjen e organizatave joqeveritare në përpjekjet për të luftuar shkretëtirëzimin dhe zbutur efektet e thatësirës; dhe

(e) të sigurojnë një ambient të aftë duke forcuar ku duhet legjislacionin ekzistues përkatës dhe, nëqoftëse nuk ekziston, të dekretojnë ligje të reja dhe të vendosin politika afatgjata dhe programe të veprimit.

Neni 6

Detyrimet e Palëve të vendit të zhvilluar

Përveç obligimeve të përgjithshme të tyre që rrjedhin nga neni 4, Palët e vendit të zhvilluar ndërmarrin:

(a) të mbështesin aktivisht, siç është rënë dakord, individualisht ose së bashku, dhe të përkrahin përpjekjet e Palëve të vendit në zhvillim që është i prekur, veçanërisht të atyre në Afrikë, dhe vendeve që janë më pak të zhvilluara, për të luftuar shkretëtirëzimin dhe zbutur efektet e thatësirës;

(b) të sigurojnë resurse financiare të qëndrueshme dhe forma të tjera të përkrahjes për të ndihmuar Palët e vendeve në zhvillim, që janë të prekura, veçanërisht ato në Afrikë, efektivisht për të zhvilluar dhe zbatuar planet dhe strategjitë e tyre afatgjata për të luftuar shkretëtirëzimin dhe zbutur efektet e thatësirës;

(c) të nxisin mobilizimin e fondeve të reja dhe shtesë që rrjedhin nga neni 20, i paragrafi 2 (b);

(d) të inkurajojnë mobilizimin e fondit nga sektori privat dhe nga burime të tjera joqeveritare; dhe

(e) të nxisin dhe lehtësojnë mundësinë për shfrytëzim të Palëve të vendeve të prekura, veçanërisht të vendeve të prekura që janë në zhvillim, për teknologji, dhe njohuri si të veprojnë.

Neni 7

Prioriteti për Afrikën

Në zbatimin e kësaj Konvente, Palët do t'i japin prioritet Palëve të vendit Afrikan të prekur, nën dritën e situatës së veçantë që mbizotëron në atë rajon, ndërsa nuk duhen neglizhuar Palët e vendeve të prekura në zhvillim, në rajone të tjera.

Neni 8

Marrëdhëniet me konventat e tjera

1. Palët do të inkurajojnë bashkëpunimin e aktiviteteve të kryera nën këtë Konventë dhe , në qoftë se janë Palë në to, të përfshirë në marrëveshjet ndërkombëtare të tjera përkatëse, veçanërisht në Konventën Kuadër të Kombeve të Bashkuara mbi ndryshimin e Klimës dhe Konventën mbi Diversitetin Biologjik, me qëllim që të nxjerrin përfitime maksimale nga aktivitetet e secilës

marrëveshje, duke shmangur ndërkohë dublimin e përpjekjeve. Palët do të inkurajojnë veprimin e programeve të përbashkëta, veçanërisht në fushat e kërkimit shkencor, të trajnimit, të observimit sistematik dhe mbledhjes e shkëmbimit të informacionit në atë masë që aktivitete të tilla mund të kontribuojnë në arritjen e objektivave të marrëveshjeve përkatëse.

2. Dispozitat e kësaj Konvente nuk do të ndikojnë mbi të drejtat dhe detyrimet e çdo Pale që rrjedhin nga marrëveshja bilaterale, rajonale dhe internacionale në të cilat ato kanë hyrë para futjes në fuqi të kësaj Konvente për të.

PJESA III
PROGRAMET E VEPRIMIT, BASHKËPUNIMIT SHKENCOR E TEKNIK DHE MASAT NDIHMËSE

Seksioni 1: Programet e veprimit

Neni 9
Drejtimi bazë

1. Në kryerjen e detyrimeve të tyre që rrjedhin nga neni 5, Palët e vendit në zhvilllim të prekur dhe çdo Palë tjetër e vendit të prekur në kuadrin e aneksit të saj të zbatimit rajonal ose, ndryshe, që ka njoftuar me shkrim Sekretariatin e Përhershëm për qëllimin e saj për përgatitjen e një programi veprimi kombëtar, do të përgatisin, bëjnë publike dhe zbatojnë si duhet, programet e veprimit kombëtar, duke përdorur dhe ndërtuar, në masën e mundshme, mbi bazën e planeve dhe programeve të suksesshme përkatëse dhe programeve të veprimit nënrajonal dhe rajonal, si elemente qendrore të strategjisë për të luftuar shkretëtirëzimin dhe zbutur efektet e thatësirës. Këto programe do të aktualizohen nëpërmjet një procesi të vazhdueshëm pjesëmarrës mbi bazën e mësimeve nga veprimet në terren, si dhe nga rezultatet e kërkimit shkencor. Përgatitja e programeve të veprimit kombëtar do të jetë ndërlidhur ngushtë me përpjekje të tjera për të formuluar politikat kombëtare për zhvillim të qëndrueshëm.

2. Në sigurimin nga Palët e vendit të zhvilluar të formave të ndryshme të asistencës nën kushtet e nenit 6, prioritet do t'i jepet mbështetjes, siç është rënë dakord, të programeve të veprimit kombëtar, nënrajonal dhe rajonal të Palëve të vendit të prekur në zhvillim, veçanërisht atyre në Afrikë, ose direkt ose nëpërmjet organizatave multilaterale përkatëse, ose të dyjave.

3. Palët do të inkurajojnë organet, fondet dhe programet e sistemit të Kombeve të Bashkuara dhe organizatat e tjera ndërqeveritare përkatëse, institucionet akademike, komunitetin shkencor dhe organizatat joqeveritare në një pozitë për të bashkëpunuar, në përputhje me mandatet dhe mundësitë e tyre, për të mbështetur përpunimin, zbatimin dhe ndjekjen e programeve të veprimit.

Neni 10
Programet kombëtare të veprimit

1. Qëllimi i programeve kombëtare të veprimit është të evidentojnë faktorët që kontribuojnë për shkretëtirëzimin dhe për masat praktike të nevojshme për të luftuar shkretëtirëzimin dhe zbutur efektet e thatësirës.

2. Programet kombëtare të veprimit do të specifikojnë rolet respektive të qeverisë, komuniteteve lokale dhe përdoruesve të tokës, si dhe burimet e disponueshme dhe të duhura. Ndërmjet të tjerash, ato:

(a) do të bashkojnë strategjitë afatgjata për të luftuar shkretëtirëzimin dhe zbutur efektet e thatësirës, do të theksojnë zbatimin dhe të integrohen me politikat për zhvillim të qëndrueshëm;

(b) do të lejojnë të bëhen modifikime në përgjigje të rrethanave në ndryshim dhe, të jenë mjaft fleksibël në nivel lokal për të përballuar kushtet e ndryshme social-ekonomike, biologjike e gjeofizike;

(c) do të kushtojnë vëmendje të veçantë zbatimit të masave preventive për tokat që nuk janë ende të degraduara ose që janë vetëm pak të degraduara;

(d) do të rrisin aftësitë dhe mjetet kombëtare klimatologjike, meterologjike dhe hidrologjike, për të siguruar një paralajmërim të hershëm për thatësirën;

(e) do të nxisin politikat dhe forcojnë kuadrot institucionale, të cilat zhvillojnë bashkëpunimin dhe koordinimin, në frymën e partneritetit, ndërmjet komunitetit donator, qeverive të të gjitha niveleve, popullsive lokale dhe grupeve të komunitetit dhe, lehtësojnë mundësitë për një informacion dhe teknologji të duhur nga popullsitë lokale;

(f) do të sigurojnë pjesëmarrjen efektive në nivel lokal, rajonal dhe nacional të organizatave joqeveritare dhe popullsive lokale, strukturave të grave veçanërisht përdoruesve të resurseve duke përfshirë fermerët dhe blegtorët dhe organizatat e tyre përfaqësuese në planifikimin e politikës, në marrjen e vendimeve dhe shqyrtimin e zbatimit e programeve të veprimit nacional; dhe

(g) do të kërkojnë rishqyrtimin e rregullt dhe përmirësojnë raportet mbi zbatimin e tyre.

3. Programet kombëtare të veprimit mund të përfshijnë, ndërmjet të tjerash, disa ose të gjitha masat e mëposhtme, për të përgatitur zbutjen e efekteve të thatësirës:

(a) vendosjen dhe/ose forcimin si duhet të sistemeve paralajmëruese të hershme, duke përfshirë mjetet lokale dhe nacionale dhe sistemet e përbashkëta në nivele nënrajonale dhe rajonale dhe mekanizmat për të të ndihmuar personat e vendosur jo mirë ambientalisht;

(b) forcimin e përgatitjes për menaxhimin e thatësirës duke përfshirë dhe planet e kontigjenteve të thatësirës në nivelet nacionale nënrajonale dhe rajonale, të cilat marrin parasysh parashikimet e klimës sezonale dhe ndërvjetore;

(c) vendosjen dhe/ose forcimin si duhet të sistemeve të sigurimit të ushqimit, duke përfshirë mjetet e marketimit dhe magazinimit, veçanërisht në zonat rurale;

(d) caktimin e projekteve alternative të jetesës që do të sigurojnë të ardhura në zonat që janë të prekura nga thatësira; dhe

(e) zhvillimin e programeve të irrigimit të qëndrueshëm për drithrat dhe për gjënë e gjallë.

4. Duke marrë parasysh rrethanat dhe kërkesat specifike të secilës Palë të vendit të prekur, programet kombëtare të veprimit përfshijnë, si duhet, ndërmjet të tjerash, masa në disa fusha ose në të gjitha fushat prioritare të mëposhtme kur ato janë të lidhura me luftën kundër shkretëtirëzimit dhe zbutjen e efekteve të thatësirës në zonat e prekura dhe në popullsinë e tyre: nxitja e mjeteve të jetesës alternative dhe përmirësimi i ambienteve e mjediseve ekonomike kombëtare me synimin për të forcuar programet që synojnë në zhdukjen e varfërisë dhe garantimin e sigurisë së ushqimit, dinamikës demografike; menaxhim i qëndrueshëm i resurseve natyrore, praktikat bujqësore të qëndrueshme; zhvillim dhe përdorim eficent i burimeve të ndryshme të energjisë, kuadrot institucionale dhe ligjore; forcimi i aftësive për vlerësimin dhe vëzhgimin sistematik, duke përfshirë shërbimet hidrologjike dhe meteorologjike dhe, rritjen e kapacitetit, arsimin dhe vetëdijen publike.

Neni 11

Programet e veprimit nënrajonal dhe rajonal

Palët e vendit të prekur do të konsultojnë e bashkëpunojnë për të përgatitur, si duhet, në përputhje me programet rajonale të zbatimit dhe programet e veprimit rajonal dhe nënrajonal, për të harmonizuar dhe rritur efiçencën e programeve kombëtare. Dispozitat e nenit 10 do t'i përkasin me disa ndryshime programeve rajonale dhe nënrajonale. Ky bashkëpunim mund të përfshijë programet e përbashkëta të rëna dakord për një menaxhim të qëndrueshëm të resurseve natyrore ndërkufitare të bashkëpunimit shkencor e teknik dhe forcimit të institucioneve përkatëse.

Neni 12

Bashkëpunimi n ërkombëtar

Palët e vendit të prekur, në bashkëpunim me Palët e tjera dhe me komunitetin ndërkombëtar, duhet të bashkëpunojnë për të siguruar nxitjen e një ambienti ndërkombëtar të aftë për zbatimin e kësaj Konvente. Ky bashkëpunim do të mbulojë edhe fushat e transferimit teknologjik si edhe të kërkimit dhe zhvillimit shkencor, mbledhjen e informacionit dhe shpërndarjen e burimeve financiare.

Neni 13

Përkrahja për zgjerimin dhe zbatimin e programeve të veprimit

1. Masat për të mbështetur programet e verpimit që rrjedhin nga neni 9 përfshijnë, ndërmjet të

tjerash:

(a) Bashkëpunimin financiar për të siguruar programet e veprimit që lejojnë planifikimin e nevojshëm afatgjatë;

(b) zgjerimin dhe përdorimin e mekanizmave të bashkëpunimit, të cilat do të aftësojnë më mirë mbështetjen në nivel lokal, duke përfshirë veprimin nëpërmjet organizatave joqeveritare, me qëllim që të nxisin riprodhimin e programeve të suksesshme pilot ku janë të domosdoshme;

(c) fleksibilitetin në rritje në hartimin, financimin dhe zbatimin e projekteve, në lidhje me drejtimin eksperimental e përsëritës, i nevojshëm për aktivitetin pjesëmarrës në nivel komunitar lokal; dhe

(d) procedurat administrative dhe buxhetore që përmirësojnë efiçencën e bahkëpunimit dhe programeve të mbështetjes.

2. Në sigurimin e një përkrahjeje të tillë për Palët e vendeve në zhvillim të prekura, prioritet do t'i jepet Palëve të vendit Afrikan dhe Palëve të vendeve më pak të zhvilluara.

Neni 14

Koordinimi dhe zhvillimi në zbatimin e programeve të veprimit

1. Palët do të punojnë së bashku, direkt dhe nëpërmjet organizatave ndërqeveritare, në zhvillimin dhe zbatimin e programeve të veprimit.

2. Palët do të zhvillojnë mekanizmat operues, veçanërisht në nivelet kombëtare dhe ato të fushës, për të siguruar koordinimin e mundshëm më të plotë ndërmjet Palëve të vendit të zhvilluar, Palëve të vendit në zhvillim dhe organizatave përkatëse ndërqeveritare dhe joqeveritare, me qëllim për të shmangur dublikimin, për të harmonizuar ndërhyrjet dhe drejtimet dhe, për të çuar në maksimum impaktin e asistencës. Në Palët e vendit të zhvilluar të prekur, prioritet do t'i jepet aktiviteteve të lidhura me bashkëpunimin ndërkombëtar me qëllimin për të çuar në maksimum përdorimin eficent të resurseve, për të siguruar asistencën që i përgjigjet atyre dhe për të lehtësuar zbatimin e programeve të veprimit kombëtar dhe të prioriteteve të kësaj Konvente.

Neni 15

Anekset e zbatimit rajonal

Elementet për shkrirje të programeve të veprimit do të seleksionohen dhe do t'i përshtaten faktorëve social-ekonomik, gjeografik dhe klimatik të aplikueshëm për Palët e rajonit të prekur, si edhe nivelit të tyre të zhvillimit. Udhëzimet për përgatitjen e programeve të veprimit dhe përmbajtjen e saktë të tyre për rajonet dhe nënrajonet e veçanta përcaktohen në anekset e zbatimit rajonal.

SEKSIONI 2: BASHKËPUNIMI SHKENCOR DHE TEKNIK

Neni 16

Mbledhja e informacionit, analiza dhe shkëmbimi

Palët bien dakord, në bazë të aftësive të tyre respektive, për të integruar dhe koordinuar mbledhjen, analizën dhe shkëmbimin e të dhënave përkatëse afatgjata dhe afatshkurtra dhe informacionin për të siguruar një observim sistematik të degradimit të tokës në zonat e prekura dhe për të kuptuar më mirë dhe mundësuar proceset dhe efektet e thatësirës dhe shkretëtirëzimit. Kjo do të ndihmojë për të përmbushur, ndërmjet të tjerash, një paralajmërim të hershëm dhe një planifikim paraprak për periudha të ndryshimeve klimatike në një formë të përshtatëshme për aplikim praktik nga përdoruesit në të gjitha nivelet, duke përfshirë veçanërisht popullsinë lokale. Për këtë qëllim, ato:

(a) do të lehtësojnë dhe forcojnë funksionimin e rrjetit global të institucioneve dhe mjeteve për mbledhjen, analizën dhe shkëmbimin e informacionit, si edhe për një observim sistematik të gjithë niveleve, të cilat, ndërmjet të tjerash:

(i) do të synojnë të përdorë standartet dhe sistemet e pajtueshme;

(ii) do të mbledhë të dhënat dhe stacionet përkatëse, duke përfshirë zonat e lagëta;

(iii) do të përdorë dhe shpërndajë teknologjinë moderne për mbledhjen e të dhënave, transmetimin dhe vlerësimin për degradimin e tokës; dhe

(iv) do të bashkëlidhë të dhënat nacionale, nënrajonale e rajonale dhe informacionin e qendrave, më ngushtë me burimet informatike globale;

(b) do të sigurojnë se mbledhja e analizave dhe shkëmbimi i informacionit i adresohet nevojave të komuniteteve lokale dhe atyre që marrin vendime, me synimin për të zgjidhur probleme specifike, dhe se komunitetet lokale janë të përfshira në këto aktivitete;

(c) do të mbështesin dhe zhvillojnë më tej programet e projektet bilaterale dhe multilaterale që synojnë përcaktimin, drejtimin, vlerësimin dhe financimin e mbledhjes, analizës dhe shkëmbimit të të dhënave dhe informacionit, duke përfshirë, ndërmjet të tjerash, grupet e integruara të treguesve fizikë, biologjikë, socialë dhe ekonomikë;

(d) do të shfrytëzojnë plotësisht ekspertizën e organizatave kompetente ndërqeveritare dhe joqeveritare, veçanërisht për të shpërndarë informacionin dhe eskperiencat përkatëse ndërmjet grupeve në rajone të ndryshme;

(e) do të japin peshë të plotë mbledhjes, analizës dhe shkëmbimit të të dhënave social-ekonomike, dhe integrimit të tyre me të dhënat fizike dhe biologjike;

(f) do të shkëmbejnë dhe do të bëjnë të disponueshëm plotësisht, hapur dhe shpejt informacionin nga të gjitha burimet e mundshme publike në lidhje me luftën kundër shkretëtirëzimit dhe zbutjen e efekteve të thatësirës; dhe

(g) në varësi të legjislacionit dhe/ose politikave respektive nacionale të tyre, shkëmbejnë informacionin mbi njohuritë lokale dhe tradicionale, duke siguruar mbrojtje adekuate për të dhe duke siguruar një kthim të duhur të të mirave që vijnë nga ajo, mbi baza të barabarta dhe me kushte të rëna dakord reciprokisht, për popullsinë lokale të interesuar.

Neni 17

Kërkimi shkencor dhe zhvillimi

1. Palët marrin përsipër, në bazë të aftësive të tyre respektive, të nxisin bashkëpunimin teknik dhe shkencor në fushat e luftës kundër shkretëtirëzimit dhe zbutjen e efekteve të thatësirës nëpërmjet institucioneve të duhura nacionale, nënrajonale, rajonale dhe ndërkombëtare. Për këtë qëllim, ato do të mbështesin aktivitetet kërkimore të cilat:

(a) kontribuojnë në njohuritë në rritje të proceseve që çojnë në shkretëtirëzimin dhe thatësirën, kontribuojnë në ndikimin dhe dallimin ndërmjet faktorëve të rastit, si ato natyrore dhe njerëzor, me synimin për të luftuar shkretëtirëzimin dhe zbutur efektet e thatësirës dhe në arritjen e një produktiviteti të përmirësuar, si dhe të një përdorimi e menaxhimi të qëndrueshëm të resurseve;

(b) i përgjigjen objektivave të përcaktuara mirë, që i drejtohen nevojave specifike të popullsisë lokale dhe që çojnë në identifikimin dhe zbatimin e zgjidhjeve që përmirësojnë standardet e jetesës së njerëzve në zonat e prekura;

(c) ruajnë, integrojnë, nxisin dhe bëjnë të vlefshme njohuritë tradicionale dhe lokale, si dhe praktikat, duke siguruar në bazë të legjislacionit dhe/ose politikave nacionale respektive, që zotëruesit e njohurive do të përfitojnë direkt mbi baza të barabarta dhe mbi kushte të rëna dakord reciprokisht nga çdo përdorim komercial i tij ose nga zhvillimi i çdo teknologjie që rrjedh nga kjo njohuri;

(d) zhvillojnë dhe forcojnë aftësitë e kërkimit shkencor nacional, nënrajonal dhe rajonal në Palët e vendit në zhvillim të prekur, veçanërisht në Afrikë, duke përfshirë zhvillimin e aftësive lokale dhe forcimin e kapaciteteve të duhura, veçanërisht në vendet me një bazë kërkimore të dobët, duke i dhënë vëmendje të veçantë kërkimit social-ekonomik pjesëmarrës dhe shumëdisiplinash;

(e) marrin parasysh, ku duhet, marrëdhëniet ndërmjet varfërisë, migrimit të shkaktuar nga faktorët e ambientit dhe shkretëtirëzimit;

(f) nxisin drejtimin e programeve të përbashkëta të kërkimit ndërmjet organizatave kërkimore dhe nacionale, nënrajonale, rajonale dhe kombëtare, si në sektorin publik dhe në atë privat, për zhvillimin e teknologjive të përmirësuara të mundshme dhe të arritshme për një zhvillim të qëndrueshëm nga pjesëmarrja efektive e popullsisë lokale dhe komuniteteve; dhe

(g) nxisin vlefshmërinë e burimeve të ujit në zonat e prekura, ndërmjet të tjerash, të hedhjes së farërave.

2. Prioritetet e kërkimit për rajone dhe nënrajone të veçanta, që pasqyrojnë kushtet lokale të ndryshme duhet të jenë të përfshira në programet e veprimit. Konferenca e Palëve do të shqyrtojë periodikisht prioritetet e kërkimit nën këshillën e Komitetit të Shkencës e Teknologjisë.

Neni 18

Transferimi, marrja, adaptimi dhe zhvillimi i teknologjisë

1. Palët ndërmarrin, siç është rënë dakord reciprokisht në përputhje me politikat dhe/ose legjislacionin institucional respektiv, të nxisin, financojnë dhe/ose ndihmojnë financimin e transferimit të marrjes, të adaptimit dhe zhvillimit të teknologjive të shëndosha e ambientalisht të qëndrueshme nga ana ekonomike dhe të pranueshme nga ana shoqërore, në lidhje me luftën kundër shkretëtirëzimit dhe/ose zbutjen e efekteve të thatësirës, me synimin për të kontribuar në arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm në zonat e prekura. Një kooperim i tillë do të drejtohet bilateralisht dhe multilateralisht, kur duhet, duke shfrytëzuar plotësisht ekspertizën e organizatave ndërqeveritare dhe joqeveritare. Palët, veçanërisht:

(a) do të përdorin plotësisht sistemet e informacionit dhe agjencitë e mbledhjes së informacinit ekzistuese nacionale, nënrajonale e rajonale dhe internacionale për shpërndarjen e informacionit për teknologjitë e vlefshme, burimet e tyre, rreziqet e tyre ambientaliste dhe kushtet e gjera ndën të cilat ato mund të kërkohen;

(b) do të lehtësojnë mundësimin në veçanti nga Palët e vendeve në zhvillim të prekura, e kushteve të favorshme, duke përfshirë kushtet e preferueshme dhe koncensionale, të rëna dakord reciprokisht, duke pasur parasysh nevojën për të mbrojtur të drejtat e pronës intelektuale ndaj teknologjive më të përshtatshme për zbatimin praktik të nevojave specifike të popullsive lokale, duke i kushtuar vëmendje të veçanta ndikimit social, kulturor, ekonomik dhe ambientalist të kësaj teknologjie;

(c) do të ndihmojnë bashkëpunimin teknologjik midis Palëve të vendit të prekur, nëpërmjet asistencës financiare dhe mjeteve të tjera të duhura;

(d) do të zgjerojnë bashkëpunimin teknologjik me Palët e vendit të prekur që është në zhvillim, duke përfshirë, kur duhet, bashkëpunimet, veçanërisht në sektorët, të cilët ndihmojnë mjetet e jetesës alternative; dhe

(e) do të marrin masat e duhura për të krijuar kushtet dhe stimujt e tregut shtëpiak, fiskal, ose ndryshe, që ndihmojnë zhvillimin, transferimin, përfitimin dhe adaptimin e teknologjisë së përshtatshme, njohurive, mënyrave dhe praktikave, përfshi masat për sigurimin e mbrojtjes adekuate dhe efektive të të drejtave të pronës intelektuale.

2. Palët, në bazë të kapaciteteve respektive të tyre dhe në varësi të legjislacionit dhe politikave të tyre respektive nacionale, do të ruajnë, nxisin dhe përdorin në veçanti teknologjinë tradicionale dhe lokale, njohuritë, mënyrat dhe praktikat dhe, për këtë qëllim, ato do të ndërmarrin të:

(a) bëjnë inventare të teknologjisë, njohurive, mënyrave dhe praktikave dhe përdorimeve të tyre potenciale me pjesëmarrjen e popullsisë lokale dhe, të shpërndajnë këtë informacion, ku duhet, në bashkëpunim me organizatat përkatëse ndërqeveritare dhe joqeveritare;

(b) sigurojnë se kjo teknologji, njohuritë dhe praktikat janë të mbrojtura në mënyrë adekuate dhe popullsitë lokale të përfitojnë direkt mbi baza të barabarta dhe të rëna dakord reciprokisht nga çdo shfrytëzim komercial i tyre dhe nga zhvillimi teknologjik që rrjedh nga to;

(c) inkurajojnë dhe ndihmojnë aktivisht në përmirësimin dhe shpërndarjen e një teknologjie të tillë, pra jo vetëm të teknologjisë, por dhe të njohurive praktike, të praktikave dhe/ose të zhvillimit të teknologjisë së re të bazuar mbi to; dhe

(d) lehtësojnë si duhet adaptimin e një teknologjie të tillë njohurive praktike dhe praktikave për përdorim të gjërë dhe, integrojnë ato siç duhet, me teknologjinë moderne.

SEKSIONI 3: MASAT NDIHMËSE

Neni 19

Ndërtimi i kapacitetit, arsimi dhe ndërgjegjësimi publik

1. Palët njohin rëndësinë e zhvillimit të kapacitetit që do të thotë, ndërtimi i institucioneve, trajnimi dhe zhvillimi i kapaciteteve përkatëse lokale dhe nacionale, në përpjekje për të luftuar shkretëtirëzimin dhe zbutur efektet e thatësirës. Ata do të nxisin, si duhet, zhvillimin e kapacitetit:

(a) nëpërmjet pjesëmarrjes së plotë në të gjitha nivelet të njerëzve lokale, veçanërisht në

nivelin lokal, sidomos të grave e të rinisë, me bashkëpunimin e organizatave joqeveritare dhe lokale;

(b) duke forcuar trajnimin dhe kapacitetin kërkues në nivel kombëtar në fushën e shkretëtirëzimit dhe luftimin e thatësirës;

(c) duke vendosur dhe/ose forcuar mbështetjen dhe zgjerimin e shërbimeve për të shpërndarë metodat e teknologjisë dhe teknikat përkatëse më efektivisht dhe, duke trajtuar agjentët e fushës dhe anëtarët e organizatave rurale në drejtime që ato marrin pjesë për konservimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të resurseve natyrore;

(d) duke nxitur përdorimin dhe shpërndarjen e njohurive, të njohurive praktike dhe praktikave të popullsisë lokale në programet e bashkëpunimit teknik, kudo që është e mundur;

(e) duke adaptuar, ku nevojitet, teknologjitë e shëndosha përkatëse për ambientin dhe metodat tradicionale të agrikulturës dhe të blegtorisë, duke ia përshtatur kushteve moderne social-ekonomike;

(f) duke siguruar trajnimin e teknologjinë e duhur në përdorimin e burimeve alternative të energjisë, veçanërisht të burimeve të rinovueshme të energjisë, me synimin për uljen e varësisë së drurit si lëndë djegëse;

(g) nëpërmjet bashkëpunimit, siç është rënë dakord reciprokisht, për të forcuar kapacitetin e palëve të vendit në zhvillim të prekur për të zhvilluar dhe zbatuar programet në fushën e mbledhjes së analizës dhe mbledhjes së informacionit që rrjedhin nga neni 16;

(h) nëpërmjet rrugëve inovuese të nxitjes së mjeteve të jetesës alternative, përfshi trajnimin e aftësive të reja;

(i) duke trajnuar personat që marrin vendime, menaxherët, dhe personelin të cilët janë përgjegjës për mbledhjen dhe analizën e të dhënave për shpërndarjen dhe përdorimin e informacionit paralajmërues të hershëm mbi kushtet e thatësirës dhe për prodhimin e ushqimit;

(j) nëpërmjet veprimit më efektiv të institucioneve nacionale ekzistuese dhe të kuadrit ligjor dhe, kur është e duhur, krijimit të institucioneve dhe kuadrove të reja së bashku me forcimin e planifikimit strategjik dhe menaxhimin;

(k) nëpërmjet programeve të shkëmbimit të vizitorëve për të çuar përpara zhvillimin e kapacitetit në Palët e vendit të prekur nëpërmjet procesit interaktiv afatgjatë të mësimit dhe studimit.

2. Palët e vendit në zhvillim të prekur do të drejtojnë, në bashkëpunim me Palët e tjera dhe organizatat kompetente ndërqeveritare dhe joqeveritare, aty kur duhet, një rishqyrtim interdisiplinar të kapacitetit të vlefshëm dhe mjeteve në nivelin lokal dhe nacional dhe, potencialin për forcimin e tyre.

3. Palët do të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin dhe nëpërmjet organizatave kompetente ndërqeveritare, si dhe me organizatat joqeveritare, të ndërmarrin dhe mbështesin vetëdijen publike dhe programet e arsimit si në vendet e prekura dhe, aty ku duhet, në Palët e vendit jo të prekur, për të nxitur mirëkuptimin e shkaqeve dhe të efekteve të shkretërizimit, të thatësirës dhe të rëndësisë së përballimit të objektivit të kësaj Konvente. Për këtë qëllim, ata:

(a) do të organizojnë fushatën e ndërgjegjësimit për publikun e gjerë;

(b) do të nxisin në baza të qëndrueshme mundësinë për marrjen nga publiku të informaiconit përkatës, të nevojshëm dhe për pjesëmarrjen në shkallë të gjerë të publikut në arsim dhe në aktivitetet e ndërgjegjësimit;

(c) do të inkurajojnë ngritjen e shoqatave që kontribuojnë në ndërgjegjësimin publik;

(d) do të zhvillojnë dhe shkëmbejnë materiale për vetëdijen arsimore dhe publike, kur nevojitet në gjuhët lokale, të shkëmbejnë dhe dërgojnë menjëherë ekspertët për trajnimin e personelit të vendit në zhvillim të prekur në zbatimin e programeve të arsimit e të vetëdijes përkatëse dhe, për të shfrytëzuar plotësisht materialin arsimor përkatës të disponueshëm në organet internacionale kompetente;

(e) do të mundësojnë nevojat arsimore në zonat e prekura, do të përpunojnë programet e shkollave dhe do të zgjerojnë, ku nevojitet , programet arsimore dhe ato programe për shkrim e këndim të të rriturve për të gjithë, në veçanti për vajzat dhe gratë, në identifikimin, konservimin dhe përdorimin e qëndrueshëm dhe manaxhimin e resurseve natyrore të zonave të prekura; dhe

(f) do të zhvillojnë programe pjesëmarrëse ndërdisiplinore që integrojnë shkretëtirëzimin dhe ndërgjegjësimin për thatësirën në sistemet e arsimit dhe në programet joformale për të rriturit dhe arsimimin praktik në distancë.

4. Konferenca e Palëve do të vendosë dhe/ose forcojë rrjetin e qendrave të trajnimit e të arsimit rajonal për të luftuar shkretëtirëzimin dhe zbutur efektet e thatësirës. Këto rrjete do të koordinohen nga një institucion i krijuar ose i caktuar për këtë qëllim, me qëllim që të trajnojnë

personelin shkencor, teknik dhe menaxhues dhe të forcojë institucionet ekzistuese përgjegjëse për arsimin dhe trajnimin në Palët e vendit të prekur, kur duhet, me synimin për të harmonizuar programet dhe për të organizuar shkëmbimet e eksperiencës ndërmjet tyre. Këto rrjete do të bashkëpunojnë ngushtë me organizatat ndërqeveritare dhe joqeveritare përkatëse për të shmangur dublikimin e përpjekjeve.

Neni 20
Burimet financiare

1. Me që është dhënë mundësia qëndrore e financimit të arritjes së objektivit të kësaj Konvente, Palët, duke i pasur parasysh mundësitë e tyre, do të bëjnë çdo përpjekje për të siguruar burime financiare adekuate që janë të vlefshme për programet e luftës kundër shkretëtirëzimit dhe zbutjen e efekteve të thatësirës.

2. Në këtë bashkërendim, Palët e vendit të zhvilluar, ndërsa i japin prioritet Palëve të vendit Afrikan të prekur, pa neglizhuar Palët e vendit në zhvillim të prekur në rajone të tjera, në përputhje me nenin 7, marrin përsipër:

(a) të mobilizojnë resurset substanciale financiare duke përfshirë grantet dhe huatë konstitucionale me qëllim për të përkrahur zbatimin e programeve për të luftuar shkretëtirëzimin dhe zbutur efektet e thatësirës;

(b) të nxisin mobilizimin e resurseve adekuate financiare në kohë dhe të parashikueshme, duke përfshirë fondet e reja dhe shtesë nga Axhensia Globale e Mjedisit të kostove në rritje, të rëna dakord, të atyre aktiviteteve që kanë të bëjnë me shkretëtirëzimin në katër zonat e veta lokale, në përputhje me dispozitat përkatëse të instrumenteve që vendos Axhensia Globale e Mjedisit;

(c) të lehtësojnë ndërmjet bashkëpunimit ndërkombëtar transferimin e teknologjisë, njohurive, njohurive praktike; dhe

(d) eksplorojnë, në bashkëpunim me Palët e vendit në zhvillim të prekur, metodat inovuese dhe stimujt për mobilizimin dhe kanalizimin e burimeve, duke përfshirë ato të fondacioneve, të organizatave joqeveritare dhe të njësive të tjera të sektorit privat, veçanërisht ato të shkëmbimit të borxhit dhe mjeteve të tjera rinovuese, të cilat rrisin financimin duke ulur borxhin e jashtëm barrë për Palët e vendit në zhvillim të prekur, veçanërisht atyre në Afrikë.

3. Palët e vendit në zhvillim të prekur, duke marrë parasysh aftësitë e tyre, marrin përsipër të mobilizojnë burimet financiare adekuate për zbatimin e programeve të tyre të veprimit kombëtar.

4. Në mobilizimin e burimeve financiare, Palët do të kërkojnë përdorimin e plotë dhe përmirësimin cilësor të vazhduar të burimeve dhe mekanizmave të të gjithë fondeve nacionale, bilaterale dhe multilaterale duke përdorur konsorciume, programe të përbashkëta dhe financim paralel dhe, do të kërkojnë të përfshijnë burimet dhe mekanizmat financuese të sektorit privat, duke përfshirë ato të organizatave joqeveritare. Për këtë qëllim, Palët do të shfrytëzojnë plotësisht mekanizmat vepruese që rrjedhin nga neni 14.

5. Me qëllim mobilizimin e burimeve financiare të nevojshme për Palët e vendit në zhvillim të prekur, për të luftuar shkretëtirëzimin dhe zbutur efektet e thatësirës, Palët:

(a) do të racionalizojnë dhe forcojnë drejtimin e burimeve tashmë të caktuara për luftën kundër shkretëtirëzimit dhe zbutjen e efekteve të thatësirës duke shfrytëzuar ato më efektivisht dhe më me efikasitet, duke vlerësuar sukseset dhe të metat, duke hequr pengesat për përdorimin efektiv të tyre dhe, ku është e nevojshme, duke orientuar programet nën dritën e drejtimit të integruar afatgjatë të adaptuar si rrjedhojë e kësaj Konvente;

(b) do të japin prioritetin dhe vëmendjen e duhur brenda organeve qeveritare të institucioneve financiare multilaterale, të mjeteve dhe fondeve, duke përfshirë bankat dhe fondet e zhvillimit rajonal, do t'i japin vëmendje mbështetjes së Palëve të vendit në zhvillim të prekur, veçanërisht atyre në Afrikë, në aktivitetet, të cilat avancojnë zbatimin e kësaj Konvente, veçanërisht të programeve të veprimit që ato ndërmarrin në kuadrin e anekseve të zbatimit rajonal; dhe

(c) do të ekzaminojnë mënyrat në të cilat mund të forcohet bashkëpunimi rajonal dhe nënrajonal për të mbështetur përpjekjet e ndërmarra në nivel nacional.

6. Palët e tjera janë të inkurajuara për të siguruar, në baza vullnetare, njohuri praktike, teknika që kanë të bëjnë me shkretëtirëzimin dhe/ose resurset financiare për Palët e vendit në zhvillim të prekur.

7. Zbatimi i plotë nga Palët e vendit në zhvillim të prekur, veçanërisht të atyre në Afrikë, të detyrimeve ndën këtë Konventë do të ndihmohen shumë nga zbatimi i Palëve të vendit të zhvilluar të detyrimeve të kësaj Konvente, duke përfshirë në veçanti ato që kanë të bëjnë me burimet financiare dhe transferimin e teknologjisë. Në plotësimin e detyrimeve të tyre, Palët e vendit të zhvilluar do të marrin parasysh plotësisht që zhvillimi ekonomik e social dhe ulja e varfërisë janë prioritetet e para të Palëve të vendit në zhvillim të prekur, veçanërisht të atyre në Afrikë.

Neni 21
Mekanizmat financiare

1. Konferenca e Palëve do të nxisë vlefshmërinë e mekanizmave financiare dhe do të inkurajojë këto mekanizma për të çuar në maksimum disponueshmërinë e fondeve për Palët e vendit në zhvillim, veçanërisht atyre në Afrikë, për të zbatuar Konventën. Për këtë qëllim, Konferenca e Palëve do të konsiderojë për adoptimin ndërmjet të tjerash drejtimet dhe politikat që:

(a) ndihmojnë sigurimin e fondeve të nevojshme në nivele nacionale, nënrajonale, rajonale dhe globale për aktivitete që rrjedhin nga dispozitat përkatëse të kësaj Konvente;

(b) nxisin drejtimet e fondeve të shumta burimore, mekanizmat, rregullimet dhe vlerësimet e tyre, në përputhje me nenin 20;

(c) sigurojnë në baza të rregullta, Palëve të interesuara dhe organizatave përkatëse ndërqeveritare dhe joqeveritare, informacion mbi burimet e disponueshme të fondeve dhe mbi strukturat e fondeve me qëllim për të lehtësuar koordinimin ndërmjet tyre;

(d) lehtësojnë vendosjen, sa më përshtatshëm, e mekanizmave, si fondet e shkretëtirëzimit nacional, duke përfshirë ato që angazhojnë pjesëmarrjen e organizatave joqeveritare, për të kanalizuar burimet financiare në mënyrë të shpejtë dhe me eficensë në nivel lokal në Palët e vendit në zhvillim të prekur, dhe

(e) forcojnë fondet ekzistuese dhe mekanizmat financiare në nivel nënrajonal dhe rajonal, veçanërisht në Afrikë, për të mbështetur më efektivisht zbatimin e Konventës.

2. Konferenca e Palëve gjithashtu do të inkurajojë sigurimin, nëpërmjet mekanizmave të ndryshëm brenda sistemit të Kombeve të Bashkuara dhe nëpërmjet institucioneve financiare multilaterale, e mbështetjes në nivel nacional, rajonal dhe nënrajonal të aktiviteteve që mundësojnë Palët e vendit në zhvillim të përballojnë detyrimet e tyre nën këtë Konventë.

3. Palët e vendit të prekur në zhvillim do të shfrytëzojnë dhe, kur është e nevojshme, vendosin dhe/ose forcojnë mekanizmat koordinuese kombëtare, programet e integruara në zhvillimin nacional, që do të siguronin përdorimin eficent të resurseve financiare të disponueshme. Ato do të shfrytëzojnë edhe proceset pjesëmarrëse që përfshijnë organizatat joqeveritare, grupet lokale dhe sektorin privat në rritjen e fondeve në zhvillimin, si dhe në zbatimin e programeve dhe në sigurimin e marrjes së fondeve, nga grupet në nivel lokal. Këto aktivitete mund të nxiten nëpërmjet koordinimit të përmirësuar dhe programimit fleksibël nga ana e tyre që e japin këtë ndihmë.

4. Me qëllim që të rrisin efektshmërinë dhe eficensën e mekanizmave financiare ekzistuese, është ngritur një Mekanizëm Global për të nxitur veprimet që çojnë në mobilizimin dhe kanalizimin e burimeve financiare thelbësore, duke përfshirë transferimin e teknologjisë, mbi bazën e një granti dhe/ose në kushtet koncensionale ose të tjera, për Palët e vendit në zhvillim të prekur. Ky Mekanizëm Global do të funksionojë nën autoritetin dhe drejtimin e Konferencës së Palëve dhe do të jetë përgjegjës ndaj tij.

5. Konferenca e Palëve do të identifikojë, në seksionin e saj të parë të radhës, një organizatë për të vendosur Mekanizmin Global. Konferenca e Palëve dhe organizata që ajo ka identifikuar, do të bien dakord mbi modalitetet prë Mekanizmin Global për të siguruar ndërmjet të tjerash që ky Mekanizëm:

(a) të identifikojë dhe të bëjë një inventar të programeve të bashkëpunimit përkatës bilateral dhe multilateral që janë të vlefshme për zbatimin e Konventës;

(b) të sigurojë këshillin, në bazë të kërkesës, ndaj Palëve mbi metodat inovuese të financimit dhe asistencës financiare dhe në përmirësimin e koordinimit të aktiviteteve të bashkëpunimit në nivel nacional;

(c) t'i sigurojë Palëve të interesuara dhe organizatave përkatëse ndërqeveritare dhe joqeveritare informacion mbi burimet e disponueshme të fondeve dhe të modeleve financuese me qëllim që të

ndihmojnë bashkëpunimin ndërmjet tyre; dhe

(d) t'i raportojnë Konferencës së Palëve, duke filluar që nga seksioni i dytë i radhës, mbi aktivitetet e saj.

6. Konferenca e Palëve, në sesionin e parë të saj, do të bëjë modifikimet e duhura me organizatën që ajo ka identifikuar për të vendosur Mekanizmin Global për veprimet administrative të këtij Mekanizmi, duke tërhequr në gjerësinë më të mundshme burimet njerëzore dhe buxhetore ekzistuese.

7. Konferenca e Palëve, në sensionin e saj të tretë të radhës, do të shqyrtojë politikat, modalitetet vepruese dhe aktivitetet e Mekanizmit Global, që rrjedhin nga paragrafi i katërt, duke pasur parasysh dispozitat e nenit 7. Mbi bazën e këtij shqyrtimi ajo do të konsiderojë dhe do të marrë veprimet e duhura.

PJESA IV
INSTITUCIONET

Neni 22
Konferenca e Palëve

1. Konferenca e Palëve tashmë është krijuar.

2. Konferenca e Palëve është organi suprem i Konventës. Ajo do të marrë, brenda mandatit të saj, vendimet e nevojshme për të nxitur zbatimin efektiv të saj. Në veçanti ajo:

(a) do të shyrtojë rregullisht zbatimin e Konventës dhe funksionimin e angazhimeve institucionale në dritën e eksperiencës së fituar në nivelet kombëtare, nënrajonale, rajonale dhe internacionale dhe mbi bazën e evolucionit të njohurive shkencore dhe teknologjike;

(b) do të nxisë dhe lehtësojë shkëmbimin e informacionit mbi masat e pranuara nga Palët dhe, vendosë formën dhe afatin për transmetimin e informacionit që do t'i paraqitet mbi bazë të nenit 26, të shqyrtojë raportet dhe të bëjë rekomandimet për to;

(c) do të ngrejë organe plotësuese që gjykohen të nevojshme për zbatimin e Konventës;

(d) do të shqyrtojë raportet e paraqitura nga organet plotësuese të tij dhe do të sigurojë udhëheqje për to;

(e) do të bjerë dakord dhe do të pranojë, me konsensus, rregullat e procedurës dhe rregullat financiare për vete dhe për organet plotësuese;

(f) do të adoptojë amendamentet ndaj Konventës që rrjedhin nga neni 30 dhe 31;

(g) do të aprovojë një program dhe buxhet për aktivitetet e saj duke përfshirë ato të organeve plotësuese të saj dhe do të ndërmarrë angazhime të nevojshme për financimin e tyre;

(h) ashtu si duhet, do të kërkojë bashkëpunimin dhe shfrytëzimin e shërbimeve dhe informacioneve të siguruara, nga organet ose agjencitë kompetente, nacionale ose ndërkombëtare, ndërqeveritare ose joqeveritare;

(i) do të nxisë dhe forcojë marrëdhëniet me konventat e tjera përkatëse, duke shmangur dublikimin e përpjekjeve; dhe

(j) do të ushtrojë funksione të tilla të tjera që mund të jenë të nevojshme për arritjen e objektivit të Konventës.

3. Konferenca e Palëve do të pranojë, në sesionin e parë të saj, rregullat e veta të procedurës me konsensus, dhe do të përfshijë procedurat e marrjes së vendimeve për çështjet që nuk janë tashmë të mbuluara nga procedurat e marrjes së vendimeve të përcaktuara në Konventë. Këto procedura mund të përfshijnë shumicën e specifikuar të kërkuar për miratimin e vendimeve të veçanta.

4. Sesioni i parë i Konferencës së Palëve do të thirret nga sekretariati i përkohshëm i referuar në nenin 35 dhe do të zhvillohet jo më vonë se një vit pas datës së hyrjes në fuqi të Konventës. Siç është vendosur nga Konferenca e Palëve, sesionet e zakonshme të dyta, të treta e të katërta do të mbahen një herë në vit dhe më pas, sesionet e zakonshme do të mbahen një herë në dy vjet.

5. Sesionet e jashtëzakonshme të Konferencës së Palëve do të mbahen në kohë të tjera, siç mund të vendoset ose nga Konferenca e Palëve në sesionin e radhës, ose me kërkesën me shkrim të ndonjë Pale, duke siguruar që brenda tre muajve kjo kërkesë t'u komunikohet Palëve nga Sekretariati i Përhershëm dhe, ajo do të mbështetet nga e pakta një e treta e Palëve.

6. Në çdo sesion të radhës, Konferenca e Palëve do të zgjedhë një Byro. Struktura dhe

funksionet e Byrosë do të përcaktohen nga rregullat e procedurës. Në caktimin e Byrosë, një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet nevojës për të siguruar një shpërndarje gjeografike dhe të barabartë dhe një përfaqësim adekuat të Palëve të vendit të prekur, veçanërisht të atyre në Afrikë.

7. Kombet e Bashkuara, agjencitë e specializuara të saj dhe çdo anëtar shtetëror ose vëzhgues që nuk janë Palë në Konventë, mund të përfaqësohen në sesionet e Konferencës së Palëve si vëzhgues. Ndonjë organ ose agjenci, në se është kombëtare ose ndërkombëtare, qeveritare ose joqeveritare, e cila është e kualifikuar në çështjet që mbulon Konventa dhe, që ka njoftuar Sekretariatin e Përhershëm për dëshirën e saj për t'u përfaqësuar në një sesion të Konferencës së Palëve si vëzhgues, mund të pranohet të paktën në se një e treta e Palëve nuk është kundër kësaj. Pranimi dhe pjesëmarrja e vëzhguesve do t'i nënshtrohet rregullave të procedurës së miratuara nga Konferenca e Palëve.

8. Konferenca e Palëve mund t'u kërkojë organizatave kompetente kombëtare dhe ndërkombëtare, që të kenë ekspertizën përkatëse për t'i siguruar asaj një informacion në përputhje me nenin 16 paragrafi (g), nenin 17 paragrafi 1 (c) dhe nenin 18 paragrafi 2 (b).

Neni 23
Sekretariati i Përhershëm

1. Është ngritur për këtë qëllim një Sekretariat i Përhershëm.

2. Funksionet e Sekretariatit të Përhershëm do të jenë:

(a) Të bëjë përgatitjet për sesionet e Konferencës së Palëve dhe organeve të saj plotësuese të vendosura në Konventë dhe t'u sigurojë atyre shërbime siç kërkohet;

(b) të hartojë dhe transmetojë raportet e paraqitura në të;

(c) të lehtësojë asistencën ndaj Palëve të vendit të prekur në zhvillim, me kërkesën e tyre, veçanërisht të atyre në Afrikë, në hartimin dhe komunikimin e informacionit të kërkuar sipas Konventës;

(d) të koordinojë aktivitetet e saj me sekretariatet e organeve dhe konventave ndërkombëtare të tjera përkatëse;

(e) të hyjë, nën drejtimin e Konferencës së Palëve, në angazhime të tilla administrative, siç kërkohet për kryerje efektive të funksioneve të tij;

(f) të përgatisë raportet për ekzekutimin e funksioneve të tij nën këtë Konventë dhe t'ia paraqesë ato Konferencës së Palëve; dhe

(g) të kryejë funksione të tjera të sekretariatit siç mund të përcaktohen nga Konferenca e Palëve.

3. Konferenca e Palëve, në sesionin e saj të parë, do të ngrejë Sekretariatin e përhershëm dhe do të përgatitet për funksionimin e tij.

Neni 24
Komiteti i Shkencës dhe Teknologjisë

1. Është ngritur një Komitet i Shkencës dhe Teknologjisë si një organ plotësues i Konferencës së Palëve për t'i siguruar asaj informacion dhe këshillim mbi çështjet shkencore teknologjike që kanë të bëjnë me luftën kundër shkretëtirëzimit dhe zbutjen e efekteve të thatësirës. Komiteti do të takohet bashkë me seksionet e rradhës të Konferencës së Palëve dhe do të jetë shumë disiplinash dhe i hapur për pjesëmarrjen e të gjitha Palëve. Ai do të përbëhet nga përfaqësues të qeverisë, kompetentë në fushat përktëse të ekspertizës. Konferenca e Palëve do të vendosë, në sesionin e saj të parë, për kushtet e referencës së Komitetit.

2. Konferenca e Palëve do të mbajë një listë të ekspertëve të pavarur me eksperiencë në fushat përkatëse. Lista do të bazohet mbi emërime të marra me shkrim nga Palët, duke marrë parasysh nevojën për një drejtim shumë disiplinash dhe një përfaqësim të gjerë gjeografik.

3. Konferenca e Palëve mundet të caktojë, nëse nevojiten persona për t'i siguruar, nëpërmjet Komitetit, informacion dhe këshillim mbi çështjet specifike që i përkasin gjendjes së artit në fushat e shkencës dhe teknologjisë për luftën kundër shkretëtirëzimit dhe zbutjen e efekteve të thatësirës. Këto do të përbëhen nga ekspertë, emrat e të cilëve merren nga lista, duke pasur parasysh nevojën e drejtimit multidisiplinor dhe përfaqësimin e gjerë gjeografik. Këta ekspertë do të kenë një të kaluar shkencore dhe një eksperiencë në fushë dhe do të caktohen nga Konferenca e Palëve me

rekomandimet e Komitetit. Konferenca e palëve do të vendosë mbi kushtet e referencës dhe modalitetet e punës së këtyre personave.

Neni 25
Rrjeti i institucioneve, agjencive dhe organeve

1. Komiteti i Shkencës dhe Teknologjisë, nën mbikëqyrjen e Konferencës së Palëve, do të sigurojë ndërmarrjen e një rishikimi dhe vlerësimi të rrjeteve ekzistuese të institucioneve, agjencive dhe organeve përkatëse, që dëshirojnë të bëhen njësi të një rrjeti. Ky rrjet do të mbështesë zbatimin e Konventës.

2. Mbi bazn e rezultateve të këtij shqyrtimi dhe vlerësimit referuar në paragrafin 1, Komiteti i Shkencës dhe Teknologjisë do t'i bëjë rekomandime Konferencës së Palëve për mënyrat dhe mjetet për të lehtësuar dhe fuqizuar rrjetin e njësive të niveleve lokale, nacionale dhe të tjera, duke siguruar që i drejtohen nevojave tematike të përcaktuara në nenin 16 deri 19.

3. Duke pasur parasysh këto rekomandime, Konferenca e Palëve:

a)do të identifikojë ato njësi kombëtare, nënrajonale, rajonale dhe ndërkombëtare që janë më të përshtatshme për t'u futur në rrjet dhe, do të rekomandojë procedurat operative në një kuadër kohe për to; dhe

b)do të identifikojë njësitë që janë më të përshtatshme për lehtësimin dhe fuqizimin e një rjeti të tillë në të gjitha nivelet.

PJESA V
PROCEDURAT

Neni 26
Komunikimi i informacionit

1. Secila Palë do t'i komunikojë Konferencës së Palëve për shqyrtim në sesionet e saj të rradhës, nëpërmjet Sekretariatit të Përhershëm, raportet mbi masat të cilat janë marrë për zbatimin e Konventës. Konferenca e Palëve do të përcaktojë kohën për paraqitjen e raporteve të tilla dhe formatin e tyre.

2. Palët e vendit të prekur do të japin një përshkrim të strategjive të vendosura sipas nenit 5 dhe çdo informacion tjetër përkatës mbi zbatimin e tyre.

3. Palët e vendit të prekur të cilët zbatojnë programet e veprimit që rrjedhin nga neni 9 deri 15 do të japin një përshkrim të detajuar të programeve dhe të zbatimit të tyre.

4. Çdo grup i Palëve të vendit të prekur do të bëjë një komunikim të përbashkët mbi masat e marra në nivelet nënrajonale dhe/ose rajonale në kuadrin e programeve të veprimit.

5. Palët e vendit të zhvilluar do të raportojnë mbi masat e marra për të ndihmuar në përgatitjen e zbatimit të programit të veprimit, duke përfshirë informacionin mbi resurset financiare që kanë siguruar, ose që ato po sigurojnë, nën këtë Konventë.

6. Informacioni i komunikuar sipas paragrafit 1 deri 4 do t'i transmetohet nga Sekretariati i Përhershëm sa më shpejt të jetë e mundur Konferencës së Palëve dhe çdo organi tjetër përkatës plotësues.

7. Konferenca e Palëve do të ndihmojë sigurimin nga vendet e prekura në zhvillim, veçanërisht të atyre në Afrikë, në bazë të ndihmës teknike dhe financiare në hartimin dhe komunikimin e informacionit në përputhje me këtë nen, si dhe në identifikimin e nevojave teknike dhe financiare që kanë të bëjnë me programet e veprimit.

Neni 27
Masat për të zgjidhur çështjet e zbatimit

Konferenca e Palëve do të konsiderojë dhe adoptojë procedurat dhe mekanizmat institucionaleve për zgjidhjen e çështjeve që mund të dalin përsa i përket zbatimit të Konventës.

Neni 28
Zgjidhja e polemikave

1. Palët do të zgjidhin çdo polemikë ndërmjet tyre përsa i përket interpretimit ose aplikimit të Konventës nëpërmjet negociatave ose mjeteve të tjera paqësore të zgjedhura nga ato vetë.

2. Kur ratifikon, pranon, miraton ose aderon në Konventë ose në çdo kohë tjetër të mëpasme, një Palë e cila nuk është një organizatë e integrimit ekonomik rajonal mund të deklarojë me shkrim drejtuar Depozituesit që, për shkak të një polemike lidhur me interpretimin ose aplikimin e Konventës, ajo njeh një ose të dyja nga mjetet e mëposhtme të deklaratës si të detyrueshme në lidhje me çdo Palë që pranon të njëjtin detyrim:

(a)arbitrim në përputhje me procedurat e pranuara nga Konferenca e Palëve në një aneks sa më shpejt të jetë e praktikueshme;

(b)paraqitjen e polemikës Gjyqit Ndërkombëtar të Drejtësisë.

3. Një Palë e cila është një organizatë rajonale ekonomike e integruar mund të bëjë një deklaratë me efekt të ngjashëm që ka të bëjë me arbitrimin në përputhje me procedurën e referuar në paragrafin 2 (a).

4. Një deklaratë e bërë për rrjedhojë të paragrafit të dytë do të mbetet në fuqi deri sa asaj i mbaron afati në përputhje me kushtet e saj ose deri tre muaj pasi njoftimi me shkrim i revokimit të saj të jetë depozituar në Depozitues.

5. Mbarimi i afatit të deklaratës, një njoftim i revokimit ose një deklaratë e re nuk do të ndikojë në asnjë mënyrë mbi procedurat pezull para një tribunali arbitrar ose Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë nëse Palët në mosmarrëveshje nuk bien dakord ndryshe.

6. Nëse Palët në një mosmarrëveshje nuk kanë pranuar të njëjtën ose çfarëdo procedurë që rrjedh nga paragrafi 2 dhe nëse ato nuk kanë qenë në gjendje të zgjidhin mosmarrëveshjen e tyre brenda 12 muajve pas njoftimit nga njëra Palë Palës tjetër që një mosmarrëveshje ekziston ndërmjet tyre, mosmarrëveshja do t'i nënshtrohet pajtimit me kërkesën e çdo Pale në mosmarrëveshje, në përputhje me procedurat e pranuara nga Konferenca e Palëve në një aneks sa më shpejt të jetë e praktikueshme.

Neni 29
Statusi i ankesave

1. Anekset formojnë një pjesë integruese të Konventës dhe, nëse nuk merret shprehimisht ndryshe, një referencë për Konventën përbën gjithashtu një referencë për anekset e saj.

2. Palët do të interpretojnë dispozitat e anekseve në mënyrën që ato të jenë në përputhje me të drejtat dhe detyrimet e tyre sipas neneve të kësaj Konvente.

Neni 30
Amendamentet për Konventën

1.Çdo Palë mund të propozojë amendamente për Konventën.

2. Amendamentet për Konventën do të pranohen në një sesion të rradhës të Konferencës së Palëve. Teksti i çdo amendamenti të propozuar do t'u komunikohet Palëve nga Sekretariati i Përhershëm të paktën 6 muaj para mbledhjes në të cilën është propozuar për pranim. Sekretariati i Përhershëm do t'u komunikojë amendamentet e propozuara edhe nënshkruesve të Konventës.

3. Palët do të bëjnë çdo përpjekje për të rënë dakord për çdo amendament të propozuar për Konventën me konsensus. Nëse të gjitha përpjekjet me konsensus janë ezauruar, dhe nuk është rënë dakord, amendamenti do të pranohet si mjet i fundit, me dy të tretat e shumicës së votave të Palëve që janë prezent dhe që votojnë në mbledhje. Amendamenti i pranuar do t'i komunikohet Depozituesit nga Sekretariati i Përhershëm. Depozituesi do ta qarkullojë në të gjitha Palët për ratifikim, pranim, miratim ose aderim.

4. Instrumentet e ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit për një amendament do të depozitohen në Depozitues. Një amendament i pranuar që rrjedh nga paragrafi 3 do të hyjë në fuqi për ato Palë që e kanë pranuar ato nëntëdhjetë ditë pas datës së marrjes nga Depozituesi, të një instrumenti të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit nga të paktën dy e treta e Palëve në

Konventë, të cilët ishin Palë në kohën e pranimit të amendamentit.

5. Amendamenti do të hyjë në fuqi për çdo Palë tjetër nëntëdhjetë ditë pas datës në të cilën Pala depoziton në Depozitues instrumentin e saj të ratifikimit, pranimit, miratimit ose të aderimit për amendamentin në fjalë.

6. Për qëllim të këtij neni dhe nenit 31 "Palët prezent dhe votues" nënkuptojnë Palët e pranishme dhe që japin votë pozitive ose negative.

Neni 31

Pranimi dhe amendamenti i anekseve

1. Çdo aneks shtesë për Konventën dhe çdo amendament për një aneks do të propozohen dhe pranohen në përputhje me procedurën për amendament të Konventës të paraqitur në nenin 30 nëse, në pranimin e një aneksi apo amendamenti shtesë të zbatimit rajonal të çdo aneksi, zbatimi rajonal, shumica e siguruar në atë nen do të përfshijë 2/3 e shumicës së votave të Palëve të rajonit të interesuar të pranishëm dhe votues. Pranimi ose amendamenti i një aneksi do t'i komunikohet gjithë Palëve nga Depozituesi.

2. Një aneks, ndryshe nga një aneks shtesë i zbatimit rajonal, ose një amendament për një aneks, ndryshe nga një amendament për çdo aneks zbatimi rajonal, që është pranuar në përputhje me paragrafin 1, do të hyjë në fuqi për të gjitha Palët e Konventës 6 muaj pas datës së komunikimit të Palëve nga Depozituesi për pranimin e një aneksi apo amendamenti të tillë, me përjashtim të atyre Palëve që nuk kanë njoftuar Depozituesin me shkrim brenda periudhës së mospranimit nga ato të një aneksi apo amendamenti të tillë. Një aneks apo amendament i tillë do të hyjë në fuqi për Palët që tërheqin njoftimin e tyre për mospranim 90 ditë pas datës në të cilën tërheqja e një njoftimi të tillë të jetë marrë nga Depozituesi.

3. Një aneks ose amendament shtesë i zbatimit rajonal për çdo aneks të zbatimit rajonal, që është pranuar në përputhje me paragrafin 1, do të hyjë në fuqi për të gjitha Palët e Konventës 6 muaj pas datës së komunikimit të Palëve nga Depozituesi për pranimin e një aneksi apo amendamenti të tillë, me përjashtim të rasteve kur:

(a) çdo Palë ka njoftuar Depozituesin me shkrim, brenda një periudhe të tillë 6-mujore, për mospranim të një aneksi shtesë të zbatimit rajonal ose të amendamentit për një aneks të zbatimit rajonal, në rastin e të cilit një aneks apo amendament i tillë do të hyjë në fuqi për Palët që tërheqin njofitmin e tyre të mospranimit 90 ditë pas datës në të cilën tërheqja e një njoftimi të tillë të jetë marrë nga Depozituesit; dhe

(b) çdo Palë ka bërë deklaratë për anekse shtesë të zbatimit rajonal apo amendamente për anekse të zbatimit rajonal, në përputhje me nenin 34 paragrafi 4, në këtë rast çdo aneks ose amendament i tillë do të hyjë në fuqi për një Palë të tillë në ditën e 90 pas datës së depozitimit të Depozituesit të instrumentit të saj të ratifikimit, pranimit, miratimit apo aderimit me një aneks apo amendament të tillë.

4. Nëse miratimi i një aneksi apo amendamenti për një aneks përfshin një amendament të Konventës, ai aneks apo amendament për një aneks nuk do të hyjë në fuqi derisa të hyjë në fuqi amendamenti për Konventën.

Neni 32

E drejta për votim

1. Me përjashtim të rasteve të përmendura në paragrafin 2, secila palë e Konventës do të ketë një votë.

2. Organizatat e integrimit ekonomik rajonal, në çështje të kompetencës së tyre do të ushtrojnë të drejtën e tyre për votë me një numër të votave të barabartë me numrin e shteteve të tyre anëtare që janë Palë në këtë Konventë. Një organizatë e tillë nuk do të ushtrojë të drejtën e votës, nëse ndonjë nga Shtetet e saj anëtare ushtron të drejtën e saj dhe e kundërta.

PJESA VI

DISPOZITA FINALE

Neni 33
Nënshkrimi

Kjo Konventë do të jetë e hapur për nënshkrim në Paris, më 14-15 tetor 1994 nga të gjitha Shtetet Anëtare të Kombeve të Bashkuara ose nga çdo agjenci e tyre e specializuar ose që janë Palë në Statutin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë dhe nga organizatat e integrimit ekonomik rajonal. Ajo do të mbetet e hapur për nënshkrim, më pas, në Selinë e Kombeve të Bashkura në Nju Jork deri më 13 tetor 1995.

Neni 34
Ratifikimi, pranimi, miratimi dhe aderimi

1. Konventa do të nënshtrohet për rafitikim, pranim, miratim ose aderim nga Shtetet ose nga organizatat e integrimit ekonomik rajonal. Do të jetë e hapur për aderim nga dita në të cilën Konventa mbyllet për nënshkrim. Instrumentet e ratifikimit, pranimit, miratimit apo aderimit do të depozitohen në Depozitues.

2. Çdo organizatë e integrimit ekonomik rajonal, e cila bëhet Palë në Konventë, edhe pse asnjë nga shtete e saj s'është Palë e Konventës, do të jetë e lidhur me të gjitha detyrimet e Konventës. Kur një ose më shumë Shtete anëtare të kësaj organizate janë, gjithashtu, Palë të Konventës, organizata dhe Shtetet e saj anëtare do të vendosin për përgjegjësinë respektive për kryerjen e detyrimeve të tyre për Konventën. Në këtë rast, organizatave dhe Shteteve anëtare nuk do t'u jepet e drejta për të ushtruar të drejtat njëkohësisht sipas Konventës.

3. Në instrumentet e tyre të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, organizatat e integrimit ekonomik rajonal do të deklarojnë shtrirjen e kompetencave të tyre për çështjet e qeverisura nga Konventa. Ato, gjithashtu, do të njoftojnë menjëherë Depozituesin, i cili më pas do të njoftojë Palët për çdo modifikim thelbësor në shtrirjen e kompetencave të tyre.

4. Në instrumentet e saj të ratifikimit, pranimit ose aderimit, çdo Palë mund të deklarojë që, përsa i përket asaj, çdo aneks shtesë i zbatimit rajonal ose çdo amendament për një aneks të zbatimit rajonal do të hyjë në fuqi vetëm me depozitimin e instrumenteve të saj të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit për sa më sipër.

Neni 35
Organizimet e ndërmjetme

Funksionet e sekretariatit, të referuara në nenin 23, të kryhen në baza të ndërmjetme nga sekretariati i caktuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në rezolutën e saj 47/188 të 22 dhjetorit 1992, deri në përfundim të sesionit të parë të Konferencës së Palëve.

Neni 36
Hyrja në fuqi

1. Konventa do të hyjë në fuqi në ditën e 90-të pas datës së depozitimit të instrumentit të 50-të të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit.

2. Për çdo shtet apo organizatë të integrimit ekonomik rajonal që ratifikon, pranon, miraton ose aderon në Konventë pas depozitimit të instrumentit të 50-të të ratifikimit, pranimit, miratimit apo aderimit, Konventa do të hyjë në fuqi në ditën e 90-të pas datës së depozitimit nga ky shtet apo organizatë e integrimit ekonomik rajonal të insturmenteve të tij të ratifikimit, pranimit, miratimit apo aderimit.

3. Për qëllim të paragrafit 1 dhe 2 çdo instrument i depozituar nga një organizatë e integrimit ekonomik rajonal do të llogaritet si shtesë e atyre të depozituara nga anëtarët shtete të organizatës.

Neni 37
Rezervat

Asnjë rezervë nuk mund t'i bëhet kësaj Konvente.

Neni 38
Tërheqja

1. Në çdo kohë pas tre vjetëve nga data në të cilën Konventa ka hyrë në fuqi për një Palë, ajo Palë mund të tërhiqet nga Konventa duke i dhënë Depozituesit njoftimin me shkrim.

2. Çdo tërheqje e tillë do të jetë efektive me mbarimin e afatit të një viti nga data e marrjes nga Depozituesi të njoftimit për tërheqje ose në një datë më të vonë, siç mund të specifikohet në njoftimin e tërheqjes.

Neni 39
Depozituesi

Sekretariati i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara do të jetë Depozituesi i Konventës.

Neni 40
Tekstet autentike

Origjinali i Konventës së tanishme, tekstet e të cilës në arabisht, kinezçe, anglisht, frëngjisht, rusisht dhe spanjisht kanë vlerë të barabartë, do të depozitohen në Sekretariatin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

Si dëshmi të nënshkrimit, të autorizuar për këtë efekt, kanë nënshkruar Konventën e tanishme.

Nënshkruar në Paris, më 17 qershor 1994.